



Republika e Kosovës * Republic of Kosova
Komuna * Municipality
Hani i Elezit



DATE: 20.06.2023
NR.09/5028/2023

KONTRATË PËR FURNIZIM

Numri i kontratës ¹: 659-23-6116-1-4-7 & KKHE-23-028-1-4-7

KOMUNA HANI I ELEZIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), përfaqësuar nga **Avdush Bajramaliu** si zyrtar i prokurimit në njërin anë; dhe

"KROSA traffic signs" SH.P.K., Rr.Gursell dhe Bajram Sylejmani, Ferizaj, NUI.810200220 (në vazhdim "Furnizuesi"), përfaqësuar nga **Halit Krosa** drejtor i OE-së në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Furnizimi dhe montimi i pasqyrave rrugore O 60 me pajisje percjellese KKHE (VM) - 23-028-1-4-7 me numër identifikues: 659-23-6116-1-4-7

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

Nr.	Grupi
1	Furnizimi dhe montimi i pasqyrave rrugore O 60 me pajisje percjellese KKHE (VM) - 23-028-1-4-7

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë 3 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë. (Ketu hyne furnizimie dhe montini me te gjitha pjeset perciellse te nevojshme)

2.3 Inkotermi² i zbatueshëm do të jetë .

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **988,00 €**: [Nëntqind e tetdhjetë e tetë euro /00 centi] Euro.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve. [N/A]

Çmimet e artikujve që janë subjekt të rregullimit të çmimit janë subjekt i rregullimeve në vijim: [N/A]

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

² Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.


6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe³ në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.


Për Autoritetin Kontraktues :

Komuna Hani i Elezit

Emri:	Avdush Bajramaliu
Pozita:	Zyrtar i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	20.06.2023
Vula:	

Për Furnizuesin :

Krosa Traffic Sing SHPK

Emri:	Halit Krosa
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	20.06.2023
Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 659-22-7979-1-4-7/C278

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Ferizaj-dega ne Kaçanik.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	9.1	[N/A]
Sigurimi	10.1	[N/A]
Programi i ekzekutimit	11	[Kohëzgjatja e kontratës është me afat prej 1 muaj apo 30 dite nga nënshkrimi i saj]
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	Te gjitha taksat dhe tatimet mbulohen nga OE-deri ne dorezim tek AK-ja
Patentat dhe licencat	13.1	[Specifikoni nëse ka ndonjë shmangie nga Neni 13 i KPK]
Cilësia e furnizimeve	18.2	Furnizimet duhet te jene te reja, te paperdorura ashtu siq jane percaktuar ne dosje te tenderit
Inspektimi dhe testimi	19.2	Artikujt do te kontrollohen per cilesi dhe sasi dhe pastaj do te pranohen nga AK-ja Komuna Hani i Elezit
Pagesa	20.1	[Pagesa do te behet pas realizimit te furnizimit i pranuar nga AK-Komuna Hani I Elezit - Pagesa do te behet brenda afati ligjor]
Dorëzimi	21.3	Në të gjitha pozicionet nënkuptohet furnizimi dhe transporti i të gjitha materialeve duke e llogaritur edhe punën e dorës për realizimin e pozicionit, më të gjitha elementet përcjellëse. Të gjitha materialet para përdorimit duhet të prezentohen për miratim nga organi mbikëqyrës
Obligimet e garancionit	24.1	[N/A]
	24.5	
Shërbimet pas shitjes	25.1	[N/A]
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	Zyra e Prokurimit – Komuna e Hanit te Elezit ose Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	[shëno te dyja] a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore ne Ferizaj dega ne Kaçanik] në pajtim me ligjin në Kosovë. b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].